



REAGIM: INDEP kërkon që Qeveria të alokoj mjete për vazhdimin e subvencionimit të masave të EE-së nga FKKEE

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka përshëndetur dhe përkrahur iniciativën emergjente të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë “Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë për shtëpitë individuale të banimit” për të promovuar eficiencën e energjisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve të Kosovës. Megjithatë, i kërkojmë Qeverisë së Kosovës që duke parë kërkesën në rritje, të alokoj mjete shtesë për të mos lënë përgjysmë një iniciativë të mirë, dhe për të përkrahur qytetarët që po tregojnë vetëdije të lartë për kursim të energjisë.

Numri i madh i aplikimeve të qytetarëve, i cili në vetëm 13 ditë shkoi në mbi 2000 tregon nevojën urgjente për masa të shtuara të eficiencës së energjisë dhe entuziasmin e gjerë të qytetarëve që mund të përfitojnë nga këto masa.

INDEP i kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë menjëherë masa duke konsideruar alokimin e mjeteve financiare shtesë për programin dhe zgjerimin e përkrahjes për qytetarët. Konkretisht, INDEP kërkon që Qeveria menjëherë të bëjë:

- Rritjen e subvencionimit prej 10 milionë eurosh të tjera nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shtëpitë individuale
- Zgjerimi i skemës për biznese dhe sektor residencial

INDEP thekson se investimi në eficiencën e energjisë jo vetëm që përputhet me përpjekjet globale për të luftuar ndryshimet klimatike, por gjithashtu ofron përfitime të menjëhershme për qytetarët e Kosovës. Investimet në eficiencë të energjisë nënkuptojnë kursim të energjisë, e rrjedhimisht zvogëlim të importit të energjisë elektrike. Alokimi i mjeteve shtesë për këto masa do të avancojë Kosovën në rrugën e tranzicionit drejtë energjisë së gjelbër.

INDEP që prej vitit 2020 ka rekomanduar përcaktimin e eficiencës së energjisë si një prioritet kombëtar të infrastrukturës nga ana e Qeverisë me hartimin e të projekteve fuqizuese të EE në infrastrukturën publike, si dhe forcimin e rolit transformues të Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë.¹ Është koha ideale që Qeveria e Kosovës të dëshmoj përkushtim të qëndrueshëm për përshpejtim të tranzicionit energjetik dhe priorizim të eficiencës së energjisë.

¹ Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – Praktikrat dhe mjetet më të mira për një rol transformues <https://indep.info/fondi-i-kosoves-per-eficience-te-energjisë-praktikat-dhe-mjetet-me-te-mira-per-nje-rol-transformues/>

Eficienca e energjisë është shtylla e parë e tranzicionit. Investimet në atë që mund t'a kursejmë duhet t'i paraprijnë investimeve në atë që duhet t'a prodhojmë. Për këtë, i bëjmë thirrje Qeverisë që të zgjeroj programin e masave të eficiencës dhe të shfrytëzoj momentumin e krijuar tek qytetarët që masat e eficiencës të jenë të gjera, të qëndrueshme dhe duke mos lënë anash askë! Duke vepruar kështu, Kosova mund të ecë në rrugën e tranzicionit, integritit evropian dhe në drejtim të përmirësimit të kualitetit të jetës për qytetarët. Është koha për investim të parave në kursim dhe jo për kursim të buxhetit që kushton!